



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN PËRFUNDIMTAR
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “MEKANIKË”

(Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK)

Kodi: F-II-22

Tiranë, 2025

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “**Mekanikë**”, **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasat e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu edhe mësimdhënësit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësimdhënësit të zhvillojnë teste të nxënësve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t’i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar
- Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “**Mekanikë**” **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK** është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë rreth 35 % të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përzgjedhura për t’u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura në të, janë si më poshtë:

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues:

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Teknologji mekanike	106	51
2	Mekanikë e zbatuar në makina	45	22
3	Hidraulika e zbatuar	28	13
4	Elektroteknikë dhe elektronikë	30	14
	TOTALI	209	100%

Temat sipas lëndëve janë:

a) Temat nga lënda “Teknologji mekanike”, kl. 10 dhe 11;

Gjithsej 106 orë

Tema 2	Vetitë mekanike të metaleve dhe provat mekanike	5 orë
Tema 5	Vetitë teknologjike të metaleve dhe provat teknologjike	5 orë
Tema 6	Çeliqet, klasifikimi, vetitë dhe përdorimi	2 orë
Tema 7	Gizat, klasifikimi, vetitë dhe përdorimi	2 orë
Tema 8	Njohuri për metalet me ngjyra dhe lidhjet e tyre	4 orë
Tema 9	Brejtja e metaleve dhe e lidhjeve të tyre	3 orë
Tema 12	Përpunimi termik i çeliqueve	3 orë
Tema 13	Përpunimi termik i gizave	2 orë
Tema 14	Çimentimi, azotimi dhe cianizimi	2 orë
Tema 17	Teknologjia e prodhimit të detaleve me derdhje	6 orë
Tema 20	Cilindrimi i metaleve	3 orë
Tema 21	Telëzimi i metaleve	2 orë
Tema 24	Stampimi vëllimor	3 orë
Tema 25	Stampimi i fletëve	3 orë
Tema 27	Saldimi me hark elektrik	3 orë
Tema 28	Saldimi elektrik me kontakt	2 orë
Tema 29	Saldimi me gaz	3 orë
Tema 30	Mënyra të veçanta saldimi (TIG, MID, MAG dhe me lazer)	5 orë
Tema 32	Prerja e metaleve me gaz dhe hark	3 orë
Tema 2	Çiftëzimet e detaleve. Standardi i tolerancave ISO	4 orë
Tema 3	Llogaritja e parametrave të çiftëzimeve	3 orë
Tema 11	Elementet e regjimeve të prerjes. Procesi i krijimit të ashklës	3 orë
Tema 12	Instrumentet prerëse, karakteristikat gjeometrike dhe funksionale. Matja e këndeve të thikave	4 orë
Tema 13	Qëndrueshmëria e instrumentit prerës, faktorët që ndikojnë	2 orë
Tema 15	Forca, momenti dhe fuqia e prerjes. Përcaktimi regjimeve të prerjes me mënyrën tabelare	2 orë
Tema 16	Njohuri për makinat metalprerëse (m.m.pr), skemat kinematike.	3 orë
Tema 18	Tornoja universale vidëprerëse. Vendosja e copave dhe instrumenteve në makinat tornuese	4 orë
Tema 19	Punimet në makinat tornuese, llojet dhe veçoritë	5 orë
Tema 20	Filetimi, teknikat themelore të punimit në makinat tornuese,	6 orë

	parametrat, llojet dhe veçoritë e tyre.	
Tema 24	Makinat shpuese	3 orë
Tema 26	Regjimet e prerjes në procesin e shpimit	3 orë
Tema 29	Struktura e bllokut funksional të një CNC: kontrollues, zbatues, aktivizues, kanale komunikimi, pajisje periferike, lidhjet me kompjuterin	3 orë

b) Temat nga lënda “**Mekanikë e zbatuar në makina**”, kl.10 dhe kl.11;

Gjithsej 45 orë

Tema 3	Lëvizja e ndryshueshme. Rënia e lirë e trupave	5 orë
Tema 4	Lëvizja rrotulluese	4 orë
Tema 6	Kinematika e trupit të ngurtë. Lëvizja translatore (tejbartëse)	2 orë
Tema 7	Hyrje në statikë. Forca dhe masa	4 orë
Tema 8	Përbërja e forcave	5 orë
Tema 14	Ekuilibri i trupit të ngurtë. Ekuacionet e ekuilibrit	6 orë
Tema 16	Njohuri të përgjithshme për dinamikën. Energjia mekanike, llojet dhe njehsimi i tyre. Ligji i shndërrimit dhe i ruajtjes së energjisë	5 orë
Tema 17	Puna dhe fuqia mekanike, raste të ndryshme	3 orë
Tema 1	Njohuri për rezistencat pasive (fërkimi) dhe vajosjen	2 orë
Tema 2	Fërkimi rrëshqitës, zbatime të tij. Kushinetat rrëshqitëse	4 orë
Tema 3	Fërkimi rrokullitës, zbatime të tij. Kushinetat rrokullisë	3 orë
Tema 9	Kuptimi për makinën, mekanizmin, dhe çiftin kinematik	2 orë

c) Temat nga lënda “**Hidraulikë e zbatuar**”, kl.10;

Gjithsej 28 orë

Tema 2	Ekuacionet bazë të hidrostatikës, trysnia hidrostatike dhe llogaritje	5 orë
Tema 8	Aparatet matës të hidrodinamikës dhe përdorimi i tyre	2 orë
Tema 4	Teorema e përgjithshme e hidrostatikës, Parimi i Paskalit, Parimi i Arkimedit, zbatimi i tyre	4 orë
Tema 5	Hidrodinamika, forcat që veprojnë mbi lëngjet në lëvizje	3 orë
Tema 11	Rrjedhjet e lëngut në vrima, hundëza dhe tubacione	4 orë
Tema 15	Pompat hidrodinamike, parimi i punës, ndërtimi dhe zgjedhja e tyre	4 orë
Tema 18	Njohuri të përgjithshme për transmesionet hidraulike	2 orë
Tema 19	Mekanizmat e shpërndarjes së lëngut në sistemet hidraulike	4 orë

d) Temat nga lënda “**Elektroteknikë dhe elektronikë**”, kl.10;

Gjithsej 30 orë

Tema 5	Llojet e rrymës elektrike: rryma e vazhduar (DC) dhe rryma alternative (AC), njëfazore dhe trefazore	3 orë
Tema 7	Rreziqet dhe mbrojtja nga rryma elektrike	2 orë
Tema 10	Qarku elektrik. Simbolet dhe paraqitja grafike. Elementët përbërës të qarkut elektrik: rezistencat, kondensatorët dhe bobinat	4 orë
Tema 11	Matjet e madhësive elektrike dhe instrumentet matës. Matësit digjitalë	2 orë
Tema 14	Ndriçuesit dhe sinjalizuesit	2 orë

Tema 20	Akumulatorët elektrikë	3 orë
Tema 23	Elementët gjysmëpërçues: diodat, tranzistorët, tiristorët dhe komponentët optoelektronikë. Skemat bazë me gjysmëpërçues	3 orë
Tema 24	Kondensatorët	1 orë
Tema 27	Automatizimi i proceseve në mekanikë. Sistemet e komandimit të automatizuar në mekanikë. Parimet kryesore	3 orë
Tema 17	Motorët elektrikë, sinkronë dhe asinkronë	3 orë
Tema 28	Sensorët, llojet dhe përdorimet e tyre në mekanikën e automatizuar	2 orë
Tema 30	Vepruesit (aktuatorët), llojet dhe përdorimet e tyre në mekanikë	2 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit profesional të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtete e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tre nivele, si më poshtë:

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Tabela 2: Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Teknologji mekanike	51	30	12	12	6
2	Mekanikë e zbatuar në		13	5	5	3

	makina	22				
3	Hidraulika e zbatuar	13	9	4	4	1
4	Elektroteknikë dhe elektronikë	14	8	3	3	2
	TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundrejt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

ë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikim profesional “**Mekanikë**” **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë janë si më poshtë:

Nr.	Kompetenca profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1	Të realizojë punime të ndryshme axhusterie me vegla e pajisje dore dhe elektrike, në copa metalike.	Detyra 1: Punime për realizimin e një objekti metalik (detali) të vështirësisë mesatare, me vegla dhe pajisje axhusterie.	20
2	Të realizojë punime saldimit me hark elektrik ose me gas të vështirësisë	Detyra 2: Punime saldimit me hark elektrik ose me gas të	25

	mesatare.	vështirësisë mesatare.	
3	Të realizojë punime të thjeshta në makinat tornuese si dhe të mirëmbajtjes së tyre.	Detyra 3: Punime për realizimin e një objekti metalik (detali) të vështirësisë mesatare, me tornim dhe mirëmbajtjes së makinave tornuese.	30
4	Të realizojë punime të thjeshta në makinat frezuese ose zdruguese si dhe të mirëmbajtjes së tyre..	Detyra 4: Punime për realizimin e një objekti metalik (detali) të vështirësisë mesatare, me frezim ose zdrugim dhe mirëmbajtjes së makinave frezuese dhe zdruguese.	25
		Shuma	100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve me “*detyra pune*”. Provimi praktik do të kryhet në repartin e shkollës për punime mekanike, ose në aktivitete private për punime mekanike.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se **3 orë**, në përputhje kjo me me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësime edhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara.
- Është *e domosdoshme dhe shumë e rëndësishme* që për çdo detyrë, që në fillim të provimit të praktikës profesionale, nga mësuesit/instruktorët(organizatorët e provimit) t’i kushtohet vëmendje “*përcaktimit dhe zbatimit të rregullave të teknikës së sigurimit dhe të ruajtjes së mjedisit*” gjatë gjithë kryerjes së detyrave për çdo nxënë.
- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve dhe veglave të punës etj.

- Gjithashtu për çdo detyrë komisioni duhet të përfshijë në vlerësim një element shumë të rëndësishëm, i cili është sistemimi dhe pastrimi i vendit dhe i mjeteve të punës pasi nxënësi ka realizuar dhe përfunduar detyrën.
- Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t'u sigurohen pajimet, materialet dhe veglat për realizimin e kësaj detyre.
- Nxënësit duhet ti realizojë të gjitha detyrat.
- Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme si dhe komunikimi, bashkëpunimi në grup, bashkëveprimi ndërmjet njëri tjetrit etj.
- Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi për produktin përfundimtar.
- Komisioni i provimit për të gjitha detyrat parapërgatit tezat e provimit ku nxënësi/grupi në mënyrë të rastësishme zgjedh njërën prej tyre. Komisioni i provimit duhet të përgatisë paraprakisht instrumentin e vlerësimit me procedurat/hapat/etapat e kryerjes së detyrave. Komisioni nuk duhet të ndërhyjë gjatë zhvillimit të provimit.
- Vlerësimi i të gjitha detyrave bëhet me listë kontrolli në bazë të instrumenteve përkatëse të vlerësimit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 1 **“Punime për realizimin e një objekti metalik (detali) të vështirësisë mesatare, me vegla dhe pajisje axhusterie”**.

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për punime mekanike, ose në aktivitete private për punime mekanike.

Nxënësit në mënyrë individuale ose në grupe realizojnë punime të ndryshme me vegla, instrumente e pajisje axhusterie, në detale të pa çiftëzuara dhe të çiftëzuara, si dhe për të prodhuar detale të thjeshta me punime axhusterie, duke kryer edhe matjet përkatëse.

Nxënësit duhet të realizojnë punime të matjes, shënimit, limimit, sharrimit, shpimit, punimit me deformim, filetimit, zmerilimit, të çmontim–montimit të çifteve, nyjeve dhe agregateve të thjeshta, etj.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t'u sigurohen:

- Komplet i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune axhusterie.
- Copa të ndryshme metalike për punime axhusterie.
- Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme.
- Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për

realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 2 **“Punime saldimit me hark elektrik ose me gaz të vështirësisë mesatare”**.

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për punime saldimit, ose në aktivitete private për punime saldimit.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të thjeshta dhe mesatare të saldimit me hark elektrik dhe të saldimit me gaz.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të parapërgatitjes dhe të realizimit të saldimeve dhe detaleve me pikim, të sheshta, kokë më kokë, me mbi vënie, këndore dhe të prerjes me saldimit me hark dhe me gaz.

Për realizimin e detyrave, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Aparatë saldimit me hark elektrik dhe me gaz.
- Materialet e nevojshme për saldimit me hark elektrik dhe me gaz.
- Kompletet e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe saldime me hark elektrik dhe me gaz.
- Copa të ndryshme metalike për punime saldimit.
- Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme që përftohen me saldimit.
- Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 3 **“Punime për realizimin e një objekti metalik (detali) të vështirësisë mesatare, me tornim dhe mirëmbajtjes së makinave tornuese”**.

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për punime mekanike, ose në aktivitete private për punime mekanike.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të ndryshme tornerie, të thjeshta dhe mesatare në detale, dhe matjet përkatëse, duke përdorur veglat, instrumenteve dhe pajisjeve të tornerisë.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të mirëmbajtjes së makinave tornuese.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punimeve të tornimit cilindrik dhe ballor, si dhe punimeve të filetimit me anë të tornos.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Makinë tornuese universale.
- Kompletet e veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për matje, shënime dhe procese pune tornimi.

- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrolle, matje, pastrime, vaisje, grasatime, shtrëngime dhe regjistrime në makinat industriale.
- Copa të ndryshme metalike për punime tornimi.
- Vajra dhe graso për makinat industriale.
- Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme që punohen me tornim.
- –Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Udhëzime për realizimin e Detyrës 4 **“Punime për realizimin e një objekti metalik (detali) të vështirësisë mesatare, me frezim ose zdrugim dhe mirëmbajtjes së makinave frezuese dhe zdruguse”**.

Kjo detyrë do të realizohet në repartin e shkollës për punime mekanike, ose në aktivitete private për punime mekanike.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të thjeshta të frezimit në makinat frezuese universale, si dhe punime të ndryshme të zdrugimit me makina zdruguese.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të frezimit të sipërfaqeve horizontale dhe vertikale, të frezimit të kanaleve dhe të prerjes së copave me frezë.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të zdrugimit të sipërfaqeve horizontale dhe vertikale, të zdrugimit të kanaleve dhe të prerjes së copave me makinë zdruguese.

Nxënësit në mënyrë individuale realizojnë punime të mirëmbajtjes së makinave frezuese dhe zdruguse.

Për realizimin e detyrës, nxënësve duhet t’u sigurohen:

- Makinë frezuese universale.
- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për punime të thjeshta frezimi.
- Copa të ndryshme metalike për punime frezimi.
- Makinë zdruguese.
- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për punime të thjeshta zdrugimi.
- Copa të ndryshme metalike për punime zdrugimi.
- Kompleti i veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të nevojshme për kontrolle, matje, pastrime, vaisje, grasatime, shtrëngime dhe regjistrime në makinat industriale.
- Vajra dhe graso për makinat industriale.
- Skica dhe vizatime teknike të detaleve të ndryshme.
- Katalogë, manuale, udhëzues, materiale të shkruara.

Nxënësit vlerësohen me listë kontrolli e cila hartohet nga komisioni i provimit dhe duhet të përmbajë të gjitha hapat e procedurës së realizimit të kësaj detyre. Kjo listë kontrolli mund të përmbajë edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale. Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës. Realizimi i pranueshëm i detyrës do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Secili nga postet e punës së lartpërmendur të ketë listë vlerësimi më vete dhe në fund të realizimit të detyrave të parashikuara, të bëhet tabela përmbledhëse e pikëve dhe të hidhet nota përkatëse.

Nxënësit ose grupet e nxënësve do të vlerësohen për realizimin e një detyre sipas listës së kontrollit.